


VITI XVII, NUMRI 8 / GUSHT 2013

HUNGARY | ALBANIA | BOSNIA AND HERZEGOVINA | CROATIA | MONTENEGRO | SERBIA | SLOVENIA

FOREVER





Filloje

DITËN ME BIZËQESHJE!

Duke ju afruar periudhës të kualifikimit për Chairman's Bonus, unë do të dëshiroja të ndaja me ju disa ide lidhur me strategjinë e menaxhimit të kohës, të cilat unë i kam parë shumë të dobishme gjatë viteve. Si sipërmarrës dhe si drejtues grupi, është jashtëzakonisht e rëndësishme që ne të kemi të përgatitur një plan strategjik për të shfrytëzuar asetin tonë më të çmuar: kohën. Duke diskutuar me distributorët tanë më të mirë, unë gjithmonë kam vënë re me admirim se sa mirë ata kanë gjetur ekuilibrin midis përgjegjesisë së tyre në biznesin e Foreverit dhe ndërkohë të ruajnë buzëqeshjen.

Planifikoje Ditën

Po sikur ta ndani ditën në një mënyrë të tillë që të rritni rendimentin tuaj? Çdo ditë unë harxhoj disa minuta vetëm për të përcaktuar gjërat prioritare, për të qënë i sigurtë që unë do ta shpenzoj të shumtën e kohës në aktivitete që kontribuojnë në suksesin e Foreverit. Disa herë mund të shmangesh lehtë nga gjërat më të rëndësishme sepse ato duken të vështira. Ben Franklioni na kujton: „Ju mund të vonoheni, por koha jo” Çelësi i planifikimit të ditës është që të jesh sa më specifik të jetë e mundur, duke i ndarë projektet e mëdha në hapa të vogla të menaxhueshme.

Përshtate programin sipas mundësisë

Një nga avantazhet më të mëdha e të punuarit me Foreverin është fleksibiliteti për të krijuar programin tuaj personal. Shumë njerëz do të preferonin të bënin detyrat më të rëndësishme kur kanë më shumë energji. A ngriheni herët? Po qe se po, kjo mund të jetë koha më e mirë e ditës për tu fokusuar në prioritetet tuaja kryesore. Duke qënë me rendiment në pikun e kohës ju ndihmon për të arritur edhe më shumë në objektivat tuaja. Me qëllim që ta shfrytëzoni kohën në mënyrë efektive, ne duhet të vlerësojmë dhe respektojmë atë që na kujton Chales Darwin: „Ai njeri që humbet kot një orë nga jeta e tij, a inuk ka kuptuar vlerën e jetës.”

Planifikoje Kohën për tui Përgjigjur Kërkesave

Si sipërmarrës dhe drejtues grupi, njerzit natyrisht kërkojnë mendimin, kohën dhe vëmendjen tuaj gjatë gjithë ditës. Si distributor i Foreverit ju ndihmoni të tjerët për të arritur një shëndet dhe mirëqënie më të mirë, kështu që ka shumë raste ku merrni telefonata, mesazhe apo E-mail. Edhe për këto duhet planifikuar koha për tui përgjigjur, sesa duke ju përgjigjur çdo kërkesë në çastin që vjen. Kjo të ndihmon që ta kontrollosh programin tënd dhe të ruash përqëndrimin.

Të gjithë kanë të njëjtën sasi kohe në dispozicion. Edhe distributorët më të sukseshëm 24 orë në ditë kanë ashtu si edhe ju. Shpesh dallimi në arritjen dhe mos arritjen e objektivave qëndron në atë sa e shfrytëzojmë kohën në avantazhin tonë. Kur ne dimë si ta menaxhojmë kohën, ne mund të ndihmojmë më mirë njeri tjetrin për realizimin e lirisë financiare, për sigurimin e një shëndeti optimal dhe bërjen e një jete të ekuilibruar. Shfrytëzoni rastin për të ndarë mundësinë Forever me të tjerët sapo ju jepet kjo mundësi, dhe investoni kohën në një mënyrë të tillë ku do të ishit krenar që e ndani këtë kohë pikërisht me të tjerët.

Rex Maughan
1 juaji

Rex Maughan


LONDRA PRET LONDON



DR. SÁNDOR MILESZ
DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Besoje, që punën time e kam hobbi, këtë mund ta them me bindje të plotë, sepse jam i dashuruar me atë, që bëj. Bashkudhëtare e jetës sonë si foreversa janë, udhëtimet e shumta. Falë gjashtëmbëdhjet vjetëve të mbushura në Forever, udhëtoj jashtzakonisht shumë; deri tani kam vizituar mbi njëqind e njëzet shtete. Sigurisht edhe unë kam vendet e mija të preferuara, si p.sh. Japonia, Kamboxha, qytetet e preferuara, si Las Vegas, Los Angeles apo Sentspeterburg. Por ka një qytet në Europë, ku kam kaluar periudhën më të gjatë, ku atje kam udhëtuar më shumë, disa herë vetëm për një prezantim të ri muzikor apo vetëm për premierën e një rockopere. Po, Londra është kalaja kulturore e Europës, dhe është vend i preferuar si për mua ashtu edhe për familjen time. Ky ishte qyteti, ku djali ynë gjashtë muajsh Matyi erdhi të dëgjonte Madonnën. Është kollaj ta duash Londrën, sepse në të kundërt me qytetet e tjera të Mretërisë, këtu edhe koha është e mirë, dhe nuk bie çdo ditë shi. Me pak fjalë, jeta kulturore është fantastike, historia sensacionale dhe ky qytet është shumë i pasur. Kjo duket në atë, që miliona turistë mbrijnë çdo muaj nga të gjitha vendet e botës për tu mahnitur me kryeqytetin e Mbretërisë. Rex Maughan përsëri ëndërroi diçka, do të na marrë ne në një nga qytetet më të bukura të botës, mund të shkojmë të shohim një ekspozitë të Salvador Dalit apo Picassos, por në darkë mund të ulemi edhe për një pjesë të Webberit si dhe mund të takohemi me ndërtuesit më të mirë të rrjetit në botë, ndërkohë Rexi na paguan udhëtimin lluksoz dhe hotelin në Londër. Forever Living International mban këtu në maj të 2014-ës Global Rally-n. E kam zakon të them, që kush jeton, lëviz dhe është forevers, ai e ka vendin atje. Kurrë nuk e kemi patur kaq afër këtë mundësi, që të mund takohemi njëherësh veç drejtuesve të kompanisë edhe me distributorët më të mirë në botë. Kjo është një mundësi gjigande dhe motivimi më i madh në ndërtimin e rrjetit Tënd. Kusht për kualifikim është një çek Chairman's Bonus ose 1500 pikë. Bëj gjithshka, që të jesh atje si i kualifikuar! Nëse vetëm tani e fillove biznesin, atëherë kërko mundësinë, që të mund të përfaqësosh grupin me mbi një mijë vetë të rajonit hungarez dhe sllavo-jugor në takimin me përmasat më të mëdha në historinë e Foreverit. Stadiumi O2 ka aftësi të pranojë njëzet mijë bashkëpunorë të Foreverit. Ne këtu, në rajonin qendror-juglindor të Europës jetojmë gjithsej tridhjet milion. Le të gumëzhijë ky stadium nga ne dhe le të udhëtojë të paktën një në dhjetë prej nesh! Në qoftë se do të shkojmë dy mijë, atëherë do të kthehen në shtëpi dy mijë vetë të motivuar, dhe duke parë rezultatet e Londrës, është e sigurt, që përsëri do të duam të bëjmë xhiro nëpër botë. Jepi vetes këtë mundësi! Bëje këtë hap, dhe do të jesh atje me ne. Më pas do të gëzohemi, do të këndojmë së bashku, dhe bashkë do të përshëndesim të kualifikuarit në podium! Ta bëjmë këtë për veten tonë, për familjen tonë dhe për të ardhmen tonë

Përpara, FLP Albania!



SUCCESS

BUDAPEST, 20 KORRIK. 2013.

KY BIZNES NUK ECËN PA PATUR PA SHOKË,
NDOSHTA KY DO TË MUND TË ISHTE MESAZHI
KRYESOR I DITËS SË SUKSESIT TË KORRIKUT. SHUMË
ÇIFTE GJITHASHTU NDANË ME NE SEKRETIN E
SUKSESIT TË PËRBASHKËT, NDËRSA NGA TË TJERË
DËGJOJMË SE SA E RËNDËSISHME ËSHTË FORMIMI I
NJË SKUADRE TË VËRTETË BASHKPUNËTORËSH.

DAY

Dita e Suksesit nis me një atmosferë më të ndezur se zakonisht. **Lui dhe orkestra Band** luajnë hitet e tyre më të mira, pastaj në skenë falnderohen sipas niveleve menaxherët, ata që kanë arritur rezultate të shkëlqyera. Drejtues të programit janë çifti Halmi, **István Halmi dhe Rita Mikola Halmine**- zafir diamant menaxherë. Edhe vetë ata kanë punuar shumë për suksesin, jo vetëm në Forever por edhe para saj. E provuan veten si sipërmarrës në shumë fusha, por vërtet e ndjejnë veten mirë vetëm këtu. Na tregojnë se objektivi i tyre është niveli diamant, deri sa ta arrijnë atë, nuk kanë për të pushuar. Po si është ky biznes? Vërtet është një biznes i mirë? Sa mund të fitosh? A do të mund ta bëjmë? - Rita premtun se në fund të Ditës së Suksesit për të gjitha pyetjet bazë do të marrim përgjigje.

„Drejtuesi i mirë, nuk thotë se çfarë duhet bërë, por si duhet bërë” thotë **Dr Sándor Milesz** që ngjitet në skenë. Së pari prej tij dëgjojmë për produktet më të reja, pastaj për programet më të mëdha të trainimit në Forever, për rëndësinë e Trainimit të Diamantëve. „Të përgatitemi për shpërthim, dua të kalojmë përsëri në vendin e parë” - i cili na njeh të dhënat e firmës më në shkallë ndërkombtare dhe me shpalljen e misionit të tij personal. „Firma jonë është firma më e mirë në botë, çështja shtrohet çfarë mund të kontribuojmë ne” - thotë ai.

Dr. Boglárka Francia, mjeke familje, mjeke urgjence, e terapive familjare dhe drejtuese e mjekëve natyralist, në një pjesë të programit na flet për përvojat mjekësore. Ajo vetë ka punuar njëkohsisht në tre vende pune, por si bashkshorte dhe nënë vendin e saj e ka gjetur kur u lidh me mundësinë Forever. Sot ajo bën atë që do: ndihmon njerzit.



Pas ngjitjes në skenë të supervisorëve dhe asistent menaxherëve, menaxherët **Gergely Almási dhe Barbara Bakos** na tregojnë si e kanë filluar këtë biznes. Çifti ekonomist ishte mësuar që ta administronte vetë kohën, mbasi kishin punuar si sipërmarrës. „Mbijetuan, kishim dhe të punësuar, bënim pushime verore, por dëshironim më shumë” – pohon Barbara. Tashmë 10 vjet më parë kishim dëgjuar për Foreverin, por jetën e ndryshoi kur takuan çiftin Halmi. „Më parë i lija të më iknin endërrat e mija, kurse tani ato i kthej në objektiva Tani kam marrë formë” – na tregon Barbara. „Për ne Foreveri ka qënë hambari i plotësimit dhe i mundësive” – e merr fjalën Gergely Almási. „Ne brënda vitit që shkoi u bëmë më të mirë. Po në ç’mënyrë? Me objektiva dhe me endërra, me asgjë tjetër. Por duhet bërë hapat që të tregon sponsori. Fati e bie të tillë jetën, që më në fund e shikon cili është kuptimi i saj. Ne përshembull do të ishim rrëzuar në disa pika, por vendosëm të jemi shembull jo i atij që dorëzohet, por i atij që ia arrin. Për sa kohë ke endërra, do të kesh edhe rezultate!”



Tibor Radóczy ishte i punësuar në një firmë kur ju fut këtij biznesi. Gjatë ditëve të javës bënte punën zyrtare, ndërsa çdo fund jave bënte prezantime. Si ekonomist i tregëtisë së jashtme dhe si ekonomist marketingu ju bë një çështje zemre, se edhe në shkollën e lartë flitet për sistemin multi level (MLM). Tani është soaring menaxher, në 5 vende ka ndërtuar biznesin e 5 menaxherëve. Pranimin e përgjegjshmërisë e konsideron të tillë: ekziston njeriu i dyanshëm: „ai që kurrë nuk gabon“, vetëm rrethanat janë të tjera: ai që përgjegjshmërisë e mban për vete, por edhe për ata që i kanë dhënë besimin atij. Edhe nga pikpamja e suksesit të biznesit ka shumë rëndësi, cilën mënyrë të menduarit të ndjekësh atë të të punësuarit apo atë të sipërmarrësit. Domethënë të presim që të tjerët të na thonë çfarë duhet të bëjmë, apo të jemi të prirur që të marrim në dorë fatin tonë dhe për këtë duhen sakrificat. Në këtë fushë Forever Partner's Business Club ka shpallur mënyrën e të menduarit të nivelit më të lartë të këtij biznesi. „Në Forever nuk duhet hyrë, por duhet të të fitojmë të drejtat, ndërsa angazhimet janë të firmës“ – sqaron Tibor Radóczy Tibor, i cili përmbledh , për çfarë ka interes të bisedosh me një bashkpunëtor potencial. „Çelësi qëndron në sigurinë, këtë duhet tu ofrojmë.“ Pas këshillave, marrim përlllogaritje profesionale: si duhet ti llogarisim pikët dhe mbi ç'baza të planifikojmë ecurinë e biznesit. „Në qoftë se do të jesh rezultativ, duhet të drejtosh skuadrën tënde, madje edhe veten, nga rrezatimi yt varet rezultati i skuadrës.“ Vazhdojnë përsëri kualifikimet, në skenë ngjiten : fituesit 60cc+, anëtarë Klubit të Conquistadorëve, menaxherët, fituesit e programit stimulues të autoveturës, menaxherët drejtues.

Pas festimit të merituar çifti më i ri **Dr Ilona Juronics Vargané dhe Géza Varga** na flasin për ndërtimin e ardhshëm të biznesit. Ilona na tregon se megjithatë është mjeke kjo nuk përbënte ndonjë avantazh, madje ashtu si edhe të tjerët luftoi me po ato vështirësi. Fillimi as për ata nuk ishte e lehtë. Ilona thekson: „suksesin mund ta arrish jo me ndërtimin e rrjetit të konsumatorëve por me ndërtimin e skuadrës të bashkpunëtorëve të tu. Suksesi është i barabartë me objektivat plus investimin, ndërsa ky i fundit do të thotë kohë, dije dhe punë e organizuar.“ Pas kësaj nuk të thot kush cilat janë detyrat e tua , ti je vet shef i vetvetes!“ Shumë i rëndësishëm është edhe dhënia e shëmbullit personal: „Tek ne 1 cc është bërë që ditën e parë, ndërsa në mes të mujait



janë bërë 4cc aktive. , por nuk mbetemi me kaq!"

Sipas Dr Ilonasuksesit nuk i bën dëm një gjë:

„le të kesh edhe një shok tëndin, që qëndron pranë teje, ashtu si i imi". Géza Varga plotëson fjalët e bashkëshortes. „Rezultatet i prodhoni ju, kjo varet vetëm nga ju. Por për këtë duhen njohur mundësitë dhe ato duhen përshtatur me mjedisin , çdo ditë tek gjithkush, mbasi ngrejmë njeri tjetrin. Dhe se kur i përvishesh? Gjithmonë moment i mirë është ai kur njeriu takohet me mundësitë. Mos u dorëzo, cakto objektiva të larta, prezantoju gjithkujt, çfarë njeriu je dhe përse punon e çfarë realizon."

Mund të kënaqemi me kualifikimin e asistent supervisorëve, pastaj **Róbert Varga** menaxher Diamant-Zafir – shtron pyetjen: Cila është e para, cilësia e jetës apo paraja? Për fat në Forever nuk ka nevojë të zgjedhësh. Në ekran shfaqen të dhëna të frikëshme: statistikat e shëndetit, numeri i vdekjeve, sasia e ilaçeve të përdorura për çdo shtëpi, sasia e lëndëve sintetike në organizmin tonë. Sëmundjet e zembrës dhe të sistemit të venave, sëmundjet kanceroze, alergjia, perdorimi i drogave dhe i duhanit... Vërtet është një një gjë që të ngjall frikën, në



të cilën për parandalimin e tyre luajnë rol të rëndësishëm mënyra e jetesës dhe e ushqyerjes sonë. Në fruta e zarzavate është paksuar në mënyrë drastike përmbajtja e vitaminave dhe e lëndëve minerale. Kjo është një nga shkaqet, pse ia vlen të konsumohen plotësuesit dietik. Ndërsa ndërtimi i biznesit flet në favor të FLP: mundësi blerje elastike, niveli i arriur në shkallën e marketingut nuk të uletdrejtues firme me etikë, një zhvillim ekonomik i vazhdueshëm në më tepër se 150 vende të botës në çdo sekondë shitet një flakon aloe vera gel, çdo ditë regjistrohen në firmë 3000 vetë. „Kjo është një mundësi biznesi e shekullit 21-të thotë Róbert Varga – ku njerzit zotërojnë gjithmonë dy butona: cilësinë e jetës dhe sigurinë materiale: dhe për të dyja kemi nevojë” Po si mund t'ia nisim? Lекtori na ndihmon se si mund të llogaritim pikët, dhe si profesionist na i shpjegon deri në fund hapat e nevojshme. „A fiton aq sa meriton? Në qoftë se do të zgjidhje, si do të doje të jetoje? – shtron pyetjen Robert Varga. „Në qoftë se rrëzohesh në një objekt, atëherë përcakto një të ri, gjithmonë duhet të ripërtërihesh! Hungaria nuk ka patur kurrë kaq nevojë për FLP sa sot, kthe nga ta duash kjo është më se e vërtetë.”



Mëso dhe argëtohu me FLP TV!

GJITHPËRFSHIRJE E AKTIVITETEVE, LEKSIONE TË DITËVE TË SUKSESIT, HISTORI SUKSESI, GASTRONOMI, KULTURË, HISTORI SHOWBIZ – GJITHSHKA DO TAG JENI TEK FLP TV NË ADRESËN:

www.fullarts.hu/flp

BERKICS MIKLÓS

FOREVER DIAMOND TRAINING

FOREVER
The Aloe Vera Company

REGIONAL SEMINAR

SYMA CSARNOK
1146 BUDAPEST, DÓZSA GYÖRGY ÚT 1.



DR. SÁNDOR MILESZ
Drejtor i Përgjithshëm



ALLAN PEASE
Autor librash, Lektor



CHRISTEL REICHLÉ
DIETMAR REICHLÉ
Diamant Menaxherë



VERONIKA LOMJANSKI
STEVAN LOMJANSKI
Diamant Menaxherë




ATTILA GIDÓFALVI
KATI GIDÓFALVI
Diamant Menaxherë

2013 12-13 TETOR
SYMA CSARNOK
2 BUDAPEST

BËHUNI PJESMARRËS TË KËTIJ TRAINIMI QË TË
JEP ENERGJI, MOTIVIM DHE DIJE FANTASTIKE!!

Bileta 10.000 Ft/ për 2 ditë, mund të blihet edhe paraprakisht në magazinat e FLP.
Rezervojmë të drejtën e ndryshimit të programit.

MIKLÓS BERKICS
Diamant Menaxher





BERKICS MIKLÓS FOREVER DIAMOND TRAINING

BUDAPEST E DIEL 9 QERSHOR 2013

Për ditën e parë të trainimit të Diamantëve shkruajtëm në numerin e kaluar të revistës dhe tani si një paradë të stareve vjen një përmbledhje e ditës së dytë. Edhe në këtë rast drejtues të programit ishin Miklós Berkics- Diamant Menaxher dhe drejtori i përgjithshëm Dr Sándor Miliesz, Zafir Menaxher.





BODO SCHÄFER ËSHTË SIPËRMARRËS, AUTOR LIBRASH, DHE TRAINUES, BABA I 3 FËMIJVE. NË KOHËN E VET ME PUNËN E DISA VITEVE U BË I PAVARUR MATERIALISHT, FITOI KOHËN E LIRË DHE LUMTURINË, DHE METODAT E TIJ KËRKON TI PËRCJELLË MË TEJ.

„Dua tju shikoj kur do të buzqeshni, sepse atëhere do të jeni shumë më të sukseshëm në jetën e këtij biznesi por edhe në jetën tuaj personale. Në qoftë se jeni në situatë të vështirë, ngrijeni shkopin e kërcimit së larti më lartë, merrni angazhime dhe i ndiqni ato. Në qoftë se do të premtoni, do të detyroheni që të gjeni dhe zgjidhjen. „Rosat“ tremben para vështirësive, „shqiponjat“ kërkojnë zgjidhjen. Mos u bëni rosë, por shqiponjë! Mos jeto me justifikime, por kërko vetëm rrugëdaljet. Nuk ka realitet objektiv, nuk ka përgjigje automatike, por ka vetëm sfida dhe mundësi. Në jetën tuaj bëni diçka çdo ditë, sepse ky është çelësi i sekretit, dhe krahas tij edhe marrja përsipër e përgjegjësisë së plotë. Megjithatë për këtë duhet vetbesim, ; besim në vetvete dhe të ardhura: dhe paralel linja që shtrihen poshtë. Megjithë përgjigjet „jo“ duhet të kesh besim në vetvete, sepse suksesin mund ta përvetësosh vetëm përkohësisht, nuk mund ta blesh, çmimin duhet tia paguash çdo ditë. Në këtë nuk je vetëm; gjithmonë duhet dikush që ka besim tek ne, një trainues, që na rri pranë, sepse gjithkush ka çaste të vështira. Sado i sukseshëm të mund të jesh, çastet më të mira do ti përjetoni në grup. Shikoni përreth: Forever Living Products funksionon, gjeni ata njerëz, që mund të jenë model dhe bëhuni si ata edhe ju! Para të gjithë neve qëndron një mundësi. Gjatë ecjes dalin edhe probleme, por problemet nuk janë kurrë të mëdha, po jemi ne të vegjël! Ta provojmë të rritemi! Po ju tregoj çfarë i premtova vetes. Krijova diçka 7 vjet më parë, dhe i premtova vetes këtë do jua bëj të njohur 1 milion njerzve. Besoj se e kam arritur objektivin. Ngrihuni për endërrat tuaja, mos u dorëzoni kurrë, merrni maksimalen e mundshme nga vetja juaj, e paë jetën një kryevepër, takohemi në majën e suksesit!

JÓZSEF SZABÓ - ZAFÍR MENAXHER, KRIJUES I FLP HUNGARI, MODEL I SHUMË NJERZVE.

„Bota nuk është vetëm e 20 vjeçarëve! Në shpirtin tim e ndjej veten Diamant, dhe këtë e përjetoj çdo ditë. Pastaj vjen koha kur duhet përqëndruar sepse gjithshka është çështje fokusimi. Vetëm këtë ki parasysh në jetë. Në qoftë se nuk çlirohesh nga gjerat anësore, nuk ke për ta arritur objektivin! por në qoftë se kujdesesh vetëm për biznesin, atëhere mendimi do të hap shpirtin tënd. Po kështu kot e lexon politikën e biznesit, në qoftë se nuk e ndjen. Që ta përjetosh me pasion kape dorën e sponsorit tënd, sepse do ta përcjellë më tej shpirtin, zemrën dhe angazhimin tënd. Mos u merr me analiza, thjesht bëje çdo ditë këtë dhe do ta bësh mirë. Vihesh në hall kur ke kartën bankare, por nuk di kodin PIN. Edhe ne kodi na duhet, por shumë herë as ti nuk e di kodin tënd. Gjatë gjithë jetës kërkojmë kodin tonë. Merre jetën dhe fatin tënd seriozisht! Në qoftë se ti nuk mundesh, as ne nuk do të mundemi, ty të duhet të luftosh për të. Përveç shëndetit liria është ndoshta vlera më e madhe. Po i ke këto të dyja do të kesh edhe para!






MICHAEL STRACHOVITZ, NJË NGA TRAINUESIT MË TË MREKULLUESHËM TË EUROPËS, DISA VITE MË PARË KRIJOI NJË RRJET PREJ 22 MIJË VETË. TANI MBAN LEKSIONE NË NJË NUMER TË MADH VENDESH. SIPAS TIJ, TEK GJITHKUSH FSHIHEN MUNDËSI TË PAFUNDME, GJITHSHKA QË MENDOJMË, APO BESOJMË MUND TA ARRIJMË.

„Ju përhëndes juve që jeni në këtë biznes, nga i cili nënat tuaja ju kanë ruajtur! A e mbani mend si kanë reaguar pjestarët e familjes? Mos qeshni. Njerzit gjithmonë dyshojnë, në qoftë se dikush bën diçka për përmirësimin e jetës, sepse je pasqyrë para tyre. Askush nuk gëzohet për sukseset e tua përveç bashkpunëtorëve të tu, ndërsa të tjerët presin që të rrëzohesh. Nk e dinë që në asgjë tjetër nuk mund të bëhesh kaq lehtë i sukseshëm sa në këtë biznes: MLM është një nga bizneset më të thjeshta në botë. Por vallë pse njëri bëhet i sukseshëm ndërsa tjetri jo? Po të njëjtat produkte, po i njëjti sistem bonusesh, po të njëjtat rregulla. Është e hidhur, por duhet ta dimë se gjithshka varet nga ne. I vetmi që mund të të bëjë të sukseshëm ose mund të të rrëzojë je ti vetë. Çdo njeri që është bërë i sukseshëm është angazhuar në tre gjëra: dije, motivim, qëndrim. Ato dije që nuk i vë në praktikë janë pavlerë. E vetmja punë e jotja është të gjesh blerësa, konsumatorë, distributorë bashkpunëtorë në këtë biznes dhe tu tregosh atyre se çfarë duhet të bëjnë. Ti pikasësh ata që janë për drejtues dhe ti trainosh ata. Por kurrë nuk ka nevojë për ata që thonë hajde ta provojmë, por për ata që e bëjnë. Dije që jo gjithkush do të eci me ty, por gjithkush vendos dhe dëshiron me siguri do të bëhet diamant. Ky është një vend, ku gjithkush mund të shpalesë talentin, mund të tregojë çfarë fsheh brënda tij, dhe nga kjo do të jetë i lumtur, dhe jo nga ajo sa shumë fiton, ajo vjen vetë. Statistikat janë të sakta: pesë kontakte – një takim, tre takime-një nëshkrim regjistrimi, tre nëshkrime-një fillon të punojë, nga tre njeri do të arrijë menaxher. Punon ë bazë të kësaj dhe ngjit nivelet! Çlirohu nga letargjia, kërko psenë dhe mënyra gjëndet. Problemi është se për çfarë mendon më shumë. Ka shumë njerëz dinë atë që nuk u duhet, megjithatë atë marrin sepse në atë janë fokusuar. Duhet të ndryshosh mënyrën e të menduarit! Atë që sot e përcakt si uni, ajo gjithmonë i takon të shkuarës. E shkuara nuk ekziston, vetëm e sotmja por për atë duhet të vendosësh lirshëm.”

ROLF KIPP- MENAXHERI DOPIO DIAMANT NGA GJERMANIA. KA FILLUAR PARA 18 VITESH, TANI ËSHTË NJË NGA RRJETNDËRTUESIT MË TË MËDHENJ NË BOTË, QË „SI RROGË TË TREMBËDHJET” MORI ÇEKUN PREJ 1.200 000 DOLLARË.

„Nuk jam ndryshe, veçse si ju. Atë që kam arritur është rezultat i grupit tim. Është e vërtetë që punoj shumë, por me mua gjithkush kështu punon. Në atë kohë nuk e dinim që do të ishim të sukseshëm, por shpresonim dhe qemë të aftë ta bënim. Unë vetë „jam fëmij i produkteve” – e filloi bisedën Rolf. Për një vit e gjysëm e kisha si punë të dytë, pastaj e kisha punën kryesore dhe në fillim bëra edhe unë plot gabime që bëhen. Sot kam 3 milion distributorë nga 80 vende të botës. Rregulli i parë është ky: në qoftë se do të ndërtohet diçka të madhe, bëje atë thjeshtë, sepse vetëm atëhere mund të të imitojnë. Mos u përpiq ti ndryshosh ata. I vetmi që mund të ndryshojë je ti vetë dhe kjo është më e vështira. Ky është një biznes që bazohet tek ndjenjat, ai bazohet tek frymëzimi, sinqeriteti dhe besimi. 90 përqind është ndjenja, 10 përqind dije. E rëndësishme është: vërtet ke besim në biznesin tënd? A je ti blerësi më i mirë, Sa nga këto produkte konsumon? Ke frymëzim për to? A e shikon me përgjegjësi në thellësinë tënde, sepse njerzit besojnë tek ti: mund ti ngresh apo mund ti ulësh ata. Jemi në një biznes sinqeriteti: nga të tjerët mund të presësh vetëm atë që ti vetë ke bërë. Dhe nuk ke punë të vështirë, sepse kurrë nuk ka patur treg të këtyre produkteve më të madh se sot dhe krahas tyre kemi një model të tillë biznesi, për të cilin asnjë njeri i zgjuar nuk mund të thotë jo. Një mundësi biznesi me garanci suksesi, me një prapavijë që të mbështet dhe ku me pak investim mund të fitosh miliona. Por secili arrin atë thellësi që meriton. Mendoje mirë cilët kërkon. Kandidatët e mi të mundshëm kanë synime, mund të frymëzohen, me mprehtësi dhe sinqeritet. Nga një njeri i tillë mos u mërzi për përgjigjen „jo”. Kur unë fillova këtë biznes. Nga 10 vetë, 9 më thoshin jo, tani ky raport është përmbysur dhe kjo është rezultat i zhvillimit prej 18 vjetësh. Gjatë kësaj kohe biznesi i Foreverit mua më dha me bollëk për gjithshka kisha nevojë. Çdo ditë jetojmë, siç do të donim, ndërsa çmimin e kemi parapaguar. Vetë mendoje sa do të ndryshonte jeta jote me paret e mija?”



DIAMANT MENAXHERI MIKLÓS, ËSHTË PREJ 15 VJETËSH NDËRTUES RRJETESH, ËSHTË „FYTYRA“ E FOREVERIT. PUNA E TIJ NË GLOBAL RALLY-N E 2013 U VLERËSUA ME ÇEKUN PREJ 425 MIJË DOLLARËSH.

Çfarë ka ndodhur me ju në 4 muajt që kaluan? Gjithshka mund të kishte ndodhur, dhe në 4 muajt që vijnë gjithshka mund të ndodhë! Në çdo rast takimi flet për gjë tjetër, ndërsa Trainimi Diamantëve është i veçantë. Detyra: punom ë shumë me mend sesa me forcë! Mua mu deshën 5 muaj që të arrija nivelin e menaxherit. Aty arrita 5 mijë dollarë, dhe prej andej pata vetëm rritje...U mbushën 16 vjet, , shumë shpërblime Profit Sharing dhe tani Chairman's Bonus, shuma që të ndryshojnë jetën, gjithsejt 5,5 milion Euro të fituara nga Forever Living Products, dhe kjo tashmë është ekstra, mbi bonusin mujor. Këtu ka vërtet para, por për to duhet punuar – së bashku. Bashkpunëtorët venë e vijnë, vetëm një njeri është fiks, ai është sponsori yt. A je gati që sponsori yt të ta ndryshojë jetën? Hiqi „syzet e humorit të keq“ , dhe buzëqesh Buzëqeshja është baraz shëndet, rezultate, suksese dhe para. Mbushe jetën tënde me gjëra të gëzuara dhe pozitive! Diku në brendësinë tënde më të thellë ke buzëqeshjen! Pastaj u vjen radha programeve stimuluese, kualifikimeve: edhe ty të pret Varna e Bullgarisë, Lake Tahoe e Amerikës, Londra...Fati yt është në dorën tënde, kujdesu që të mos mbetet në duart e të tjerëve!




Oferta jonë deri sa të ketë gjëndje:

Kush blen të paktën 2 bileta në një numer kodik për Trainimin Diamant të muajit Tetor, merr falas një memorie flash me regjistrimet zanore të trainimit të muajit shkurt. Oferta jonë vazhdon për sa kohë të ketë gjëndje. Bëhuni edhe ju pjestarë të këtij trainimi që të mbush me energji, motivim dhe dije!

BEOGRAD, 23.06.2013

Drejtuesit e programit të seminarit të parë veror, ishin menaxherët Svetlana dhe Predrag Živković antarë të grupit fantastik të Kragujevacit. Shumë nga bashkpunorët tanë të motivuar kanë të njëjtin objektiv: të jetojnë jetë më cilësore.



Drejtuesi i FLP-s së Serbisë, **Dr. Branislav Rajić** përmbodhi shkurtimisht aktivitetin e firmës për gjashtë mujorin e parë. Prirjet janë të mira, po ashtu edhe entuziazmi drejt punës, nuk kemi mungesë energjie, dhe para nesh qëndrojnë sfida të tilla, të cilat janë të arritshme me një planifikim të mirë, me punë në grup dhe energji pozitive - bile edhe me buzëqeshje, ashtu siç e thotë edhe një slogani i FLP-s: Forever Smile!

Firma jonë ndjek prirjet e botës, me produkte gjithmonë e më të reja e me cilësi të lartë. Prezenca prej shumë vitesh i produkteve tona në tregun botëror, është rezultat i punës sakrifikuese të specialistëve të shkëlqyer, dhe përdorimi i teknologjisë moderne. Gjatë perfeksionimit janë marrë në konsideratë kërkesa e njerëzve për plotësues ushqimorë. Larminë e produkteve të reja për 2013-ën e prezantuan menaxheri **Siniša Blašković** dhe specialistia e kozmetikës **Dragana Nikolić**.



Plotësuesit ushqimorë janë mjetet më të favorshme për të fituar mbi efektet negative të shekullit 21. Stresi, nxitimi, bioritmi i përmbysur, papërgjegjësi personale: janë faktorët më negativë të stilit modern të jetës. Ekziston zgjidhja, dhe pikërisht FLP-ja ofron zgjidhjen e duhur. Faleminderit **dr. Biserka Lazarević** leksionin e shkëlqyer.

Ndoshta në çdo Ditë Suksesi pjesën më të rëndësishme e përfaqësojnë eksperiencat e përdoruesve të produkteve, si dhe raportet e doktorëve. Kemi rastin të dëgjojmë ato dëshmi personale, të cilët survejimet dhe përvojat e tyre



i ndajnë pa egoizëm me të pranishmit, duke kontribuar me dashje apo padashje, që duke dëgjuar eksperiencat edhe të tjerë të ndihmojnë vetveten. Ndërsa doktorët - duke shkuar më tej, që edhe ata i përdorin - në punën e tyre të përditëshme japin këshilla, ku nëpërmjet saj hapin përpara programit të firmës dimensione të reja. **Dr. Gabriella Tót** - edhe ajo vetë është menaxhere e FLP - e drejtoi pjesën e saj të programit në mënyrë brilante.

Ashtu sikurse edhe vetë biznesi i FLP-s është një lloj argëtimi, nuk qëndron larg nesh, që edhe në seminare të argëtohemi. Ndihmësi kryesor për këtë ishte **Igor Starović**, njeriu i parë i grupit „Divlji kesten”, mjeshtër i krijimit të atmosferës. Programi argëtues ishte një hyrje e duhur për vazhdimin e pjesës së biznesit në Ditën e Suksesit.

FLP-ja është një firmë e tillë, nëpërmjet së cilës mund të realizohen njëmijë dëshira tonat, por ndërkohë duhet të respektojmë disa ligje bazë: programim, përcaktimi i takimeve të biznesit, dëgjimi i të tjerëve, dhe nëpërmjet saj përzgjedhja e mënyrës së prezantimit të mundësisë së biznesit, ndjekja rregullisht e konsumatorëve. Që e gjithë kjo funksionon, për këtë është shembull menaxherja **Jovanka Štrboja**, e cila edhe vetë i përdor të gjitha ato që u rradhitën më sipër në ndërtimin e biznesit të FLP-s.

Kualifikimet janë "pasqyrë" e punës tonë. Përshëndetëm supervizorët, si dhe menaxherët e rinj të Serbisë: **Dani Radović, Eleonóra dhe János Baranyi**.

Më pas shpërblyem antarët e rinj të Klubit të Sundimtarëve dhe 60 cc+, ose ata, që realizojnë në një muaj me grupin e tyre të paktën 60 pikë personale dhe jo menaxheri. Ata me të vërtetë janë mjeshtër të zanatit të tyre!





Në programin promovues siguruan pjesëmarrjen e tyre edhe për 36 muaj të tjerë Nevenka dhe **Vladimir Jakupak** në nivelin e parë, si dhe **Veronika dhe Stevan Lomjanski** me realizimin e nivelit të tretë.

Të gjithë ne kemi ëndrra, por nga më të shumtët mungon besimi, që të qendrojnë pranë ëndrrave. Secili prej nesh e ka të drejtën, që të marrë diçka edhe nga jeta, jo vetëm të ulemi dhe të presim, që të na bjerë fati në prehër. Çdo gjë është shumë më e mirë se sa të rrish - bën mesazh menaxheri **Vitomir Nešić**. Qëllimi i tij është, që qoftë nëpërmjet produkteve, qoftë nëpërmjet planit marketing ta fusë FLP-n në çdo familje.

Niveli i assistant supervizorit është shkalla e parë e planit marketing të FLP-s. Kjo shënon pjekjen e biznesit dhe fillimin në të vërtetë të sipërmarrjes së pavarur. I përshëndesim supervizorët e rinjë!

Një pjesë e takimeve me FLP-n shënon pikën e kthimit: dalim nga rutina e përditëshme: mund të ndryshojmë mënyrën e të parit të botës. Në të vërtetë FLP-ja është mënyrë e ndërtimit në grup, të gjithëve ju jep në dorë një mjet të shkëlqyer : kutin Touch of Forever. Kjo kuti shënon thelbin e biznesit tonë: ruan gjendjen aktive, garanton sigurinë e parave si dhe reklamën më të mirë për fillimin e sipërmarrjes private - mesazhon **Marija Buruš** safir menaxhere.

Takimi i radhës do të jetë më 23 shtator 2013, kur i presim të gjithë me ide dhe suksese të reja biznesi.

Dr. Branislav Rajić,
drejtori rajonal i FLP serbe



LAST MINUTE!

Periudha e kualifikimi: nga
1 Maj deri 31 Gusht 2013.

KUSH MUND TË KUALIFIKOHET?

Çdo distributor i ri apo i vjetër, që nga niveli aktual ngjitet të paktën një shkallë më lartë në planin e marketingut (nga shkalla e distributorit mund të kualifikohesh vetëm në qoftë se arrin shkallën e supervizorit). Mund të marrin pjesë edhe të risponsorizuarit!

CILAT JANË KUSHTET EKZAKTETË KUALIFIKIMIT?

Ngjitu një nivel! Gjatë periudhës të kualifikimit të jesh aktiv (4 cc të reja, nga të cilat të paktën 1 cc në kodin personal) që nga muaji i parë i plotë, domethënë në qoftë se je regjistruar në 15 Qershor, atëhere që nga 1 Korriku. Nga niveli ekzistues i distributorit në planin e marketingut të ngjitesh një nivel (ata që janë në nivelin e distributorit të ngjiten në nivelin e supervizorit) Ky është niveli i I-rë i Holiday Rally.

Pas kualifikimit deri në fund të periudhës të kualifikimit të plotësosh të gjitha kushtet e kualifikimit, për shembull në qoftë se dikush nga niveli i distributorit apo asistent supervizorit arriti në Qershor nivelin e supervizorit, atëhere qershori bashkë me korrikun dhe korriku bashkë me gushtin duhet të jenë me 25 pikë. Në qoftë se nivesh nga niveli i supervizorit dhe në qershor arrite nivelin e asistent menaxherit, atëhere krahas ruajtjes të qënies aktive, në qershor dhe korrik së bashku dhe korrik-gusht së bashku xhirua jote duhet të jetë përsëri 75 pikë, e kështu më tej. Ky është niveli i II-të i kualifikimit për Holiday Rally.

Në qoftë se je regjistruar në muajin e fundit të periudhës të kualifikimit, dhe ke plotësuar kushtet e periudhës të kualifikimit të Holiday Rally, atëhere, nuk mund të marrësh pjesë në akomodimin e VIP-ave, por natyrisht në nivelin e I-rë të kualifikimit. Ai që gjatë periudhës të kualifikimit ka ngjitur dy e më shumë shkallë në nivelin e marketingut, ai merr pjesë në akomodimin e VIP-ave, pra arrin nivelin e II-të.

AKOMODIMI:

Në hotelin me 5 yje „Ambasador”, të gjitha përfshi. Bashkpunëtorët e kualifikuar për Nivelin e II-të do të shkojnë me autobus VIP, dhe gjatë aktivitetit do të shërbehet në bufe VIP-ash dhe nuk do të ketë pika shitje për VIP-a duke mos pritur në radhë. Bashkpunëtorët e Nivelit të I-rë, udhëtimin e tyre duhet ta mbulojnë me shpenzimet e tyre, por sigurisht mund të marrin falas shërbime të firmës.

KUR DHE KU DOTË JETË HOLIDAY RALLY?

4-5 Tetor 2013, në Opatija të Kroacisë.

HR

HOLIDAY RALLY

Opatija



Global Rally 2014

do të jetë një nga aktivitetet më tërheqës dhe më magjepsës të Foreverit. Në Stadiumin O2 të Londrës, do të festojmë dhe vlerësojmë së bashku me 20.000 distributorë që do të vijnë nga të gjitha anët e botës, rezultatet e distributorëve të përmasave botërore të Foreverit.

BELIEVE IT. KI BESIM!

Global Rally 2014 është një mundësi e jashtëzakonshme për tu takuar me më të mirët e këtij biznesi, për të marrë pjesë në trainimet më të organizuara dhe më të mira, dhe për të qënë dëshmitar i kualifikimeve të niveleve më të larta. Ata që do të kualifikohen për Global Rally 2014, do të kenë një vend të veçantë ku do të na prezantojnë konceptet e biznesit tone, ku nuk ekzistojnë kufij, sepse ky është një biznes pa kufij.



2014/20

DESTINATION LONDON. DESTINACIONI LONDËR

Global Rally do të na japë mbresa të veçanta, me darka për të kualifikuarit, me programe trainimi e të kohës së lirë, me vlerësime të niveleve të arritura, prezantim të produkteve dhe trainim për to., aty jepen kualifikimet për Chairman's Bonus dhe gjatë gjithë kësaj kohe , të kualifikuarit tanë natyrisht i presin hotelet më të mire dhe më luksoze që ndodhen në një zone magjepsëse. Përgatitu seriozisht për të udhëtuar për në **Londër!**

ACHIEVE IT. REALIZOJE!

Kushtet e Global Rally janë të realizueshme, dhe edhe TI mund të jesh atje; për këtë duhet vetëm durim dhe përkushtim. Mos harro, këtu nuk është fjala për çfarë përjeton gjatë këtij udhëtimit, por edhe për vetë udhëtimin tuaj. Programi stimulus i Foreverit të ndihmon që të zhvillohesh, të përcaktosh me mençuri objektivat, sepse fiton eksperiencën tënde, deri ku mund të arrish, dhe pastaj i futesh që ta realizosh vërtet. Këtu mëson metodat më të mira, dhe në këtë mënyrë biznesi yt ecën në drejtimin e duhur.

LIVE IT. PËRJETOJE

Kushtet e kualifikimit për Global Rally janë të thjeshta. në një vit kalendarik të arrish minimumi 1500 CC ose të kualifikohesh për Chairman's Bonus. Po, vetëm kaq! Rregullat nuk janë të komplikuara, nuk ka pjesë me shkronja të vogla! Të kualifikohesh nga 1 Janari 2013 deri 31 Dhjetor 2013 me 1500 pikë ose për Chairman's Bonus, dhe për të tjerat kujdeset Foreveri. Sa pike arrin në një vit kalendarik, pikërisht nga kjo varet se si mund ta përjetosh Global Rally-n.



,000/02

Por çdo të thotë kjo për ty ?

Global Rally dhe Chairman's Bonus janë programe stimuluuese që të ndihmojnë që në biznesin tënd të arrish në nivele më të larta. Pengesat që ekzistojnë me rregullat e mëparshme janë hequr. Tashmë ajo që ndryshon është që nuk ka justifikime të tjera për zhvillimin e biznesit global. Ju urojmë shumë suksese që ta realizoni !

Përsa i përket programit stimulus Chairman'Bonus mund të lexoni më me hollësi në faqen tonë të internetit:

www.foreverliving.com
www.foreverglobalrally.com



FOREVER



TAKIMI

„Forcën e një grupi e përbën shkalla e guximit të njerzve që e përbëjnë atë”

(Sokrates)

NË KROACI

MENAXHERËT E FOREVER LIVING PRODUCTS TË KROACISË NË PRONAT E JEHIĆI, PRANË POREČ-IT KALUAN DY DITË TË PAHARRUESHME PUNE DHE MIQËSIMI. GJITHSHKA ISHTE NË FAVORIN TONË: MJEDIS I MREKULLUESHËM, BASHKPUNËTORË ME HUMOR TË LARTË, MADJE EDHE DIELLI E DINTE SE KUR DUHEJ TË DIGJTE.

Dr. **László Molnár**, drejtori rajonal i FLP kroaci, falnderon pjesmarrësit. Na kujton se si parakusht i çdo suksesi është rrezatimi i energjive pozitive, sepse vetëm kështu mund të tërheqim ata që na ngajnë neve. Në fjalën e tij flitet për unitetin: sepse vetëm të bashkuar mund të bëjmë gjëra të mëdha.

Programin e drejtoi me vrullin e tij **Dr Albert Keresztényi** – senior menaxher, i cili ndau pa egoizëm eksperiencën e tij me pjesmarrësit.

Manda Korenić – senior menaxhere në leksionin e saj me titull „Korrektesia në punë” na dha mesazhin e

mëposhtëm: Skuadra jonë tani konsiderohet një markë e veçantë, prandaj nuk na lejohet që gjatë punës ta njollosim famën e kësaj marke. Madje duhet ti bësojmë të gjithë bashkpunëtorët tanë që të punojnë si duhet.”

Pas kësaj **Jadranka Kraljić-Pavletić** – menaxhere, me leksionin e saj na çon në ishujt Hawaii, ku kaloi ditë të paharrueshme, megjithse e mori malli për bashkpunëtorët e saj këtu në Kroaci! Në leksionin plot ndjenja, duke na nxitur të gjithëve që në Rallin e vitit të ardhshëm të mbushim vendet e lira të autobuzit, që na takon neve dhe gjatë udhëtimit të valëvitet kudo flamuri me kuadratet kuq-e bardhë me stemën kroate.

Në leksionin e **Sonja Jurović** - soaring menaxhere, na jepet mesazhi i qartë: „Ndryshoni në atë mënyrë siç do të dëshironit të ishit!”

Tihomir Stilin - senior menaxher, është shembull i gjallë i asaj se si një ide mund të ndryshojë jetën tonë.

Zlatko Jurović - soaring menaxher, në mesazhin e tij na thotë: „Investoni për trainimin tuaj, dhe pstatj dijet e fituara do të mbushin plot xhepat tuaj!

Shembujt pozitiv të lektorëve na bëjnë të shtërngojmë radhët, na forcojnë dhe na mësojnë neve. Është një gjë e bukur të shikosh unitetin

Pas leksioneve, bashkpunëtorët e FLP patën një darkë të shijshme dhe të bollshme, të shoqëruar me këngë e valle, madje me një tortë ditlindjebefasuum edhe bashkpunëtoren tonë **Ivanka Vidičke**.


Por surprizën më të madhe na i shkaktoi zyra e FLP të Zagrebit, me leksionin e ditës së diel nga zafir menaxherja **Ágnes Krizsó**, e cila na foli për objektivat duke i vënë të gjithë në lëvizje. Duhet të kemi endërrat tona, sepse endërrat mund të realizohen, ndërsa pa endërra nuk shkon dot asgjëkund!

Pas leksioneve, menaxherët matën forcat e tyre në disa degë sporti jo të zakonshme. U formuan 4 skuadra: Shqiponja, Aktivatori, Stuhia dhe Diamanti. Skuadra Stuhia u bë e njohur për forcën e saj duke fituar në tërheqjen e litarit. Skuadra e shqiponjës ishte aq e kujdeshme sa që gjatë garës nuk theu asnjë vezë.

Skuadra e Aktivatorit na bëri për të qeshur, ndërsa skuadra e Diamantit në shtyrjen e karrocës, dhe mundi të fitonte në futbollin modern.

U mbushëm me energji pozitive, dhe Jehnići u pushtua nga idetë tona.





ALOE INFO CENTAR

ZYRË E RE INFORMACIONI E FOREVERIT NË SZABADKÁ

MENAXHERËT E KUALIFIKUAR KOHËT E FUNDIT TË FOREVER LIVING PRODUCTS, JÓZSEF BARANYI DHE BASHKSHORTJA E TIJ ELEONORA, BRËNDA KUADRIT TË ZYRËS TË INFORMACIONIT TË FIRMËS SË TYRE PRIVATE QË EKZISTON PREJ 20 VJETËSH HAPËN NJË ZYRË INFORMACIONI NË SZABADKA, NË SERBI.

Józsefi dhe Eleonora janë një skuadër e mirë koordinuar. Józsefi është biznesmen, Eleonora është mjekë alternative. Prandaj thonë se ata gjetën Foreverin, mbasi shkrin biznesin me jetën e shëndetshme. “ Në ceremoninë e hapjes të ftuar nderi, ishin Dr Sándor Milesz, anëtar i nderuar I Urdhërit të Kalorësit të Maltës, studjues, nënkryetar i Shoqatës të Mjekëve Alternativë të Hungarisë, drejtor i përgjithshëm i FLP të Hungarisë dhe rajonit të Ballkanit, zafir menaxher, dhe Tibor Radoczki, economist i diplomuar, soaring menaxher, drejtor rajonal I Forever Living Products si dhe mjekja Dr Ilona Gurka Radoczkiné, soaring menaxhere.

Dr Sándor Milesz në ceremoninë e hapjes deklaroi: Foreveri filloi në Serbi aty nga viti 1998. Ngadalë, hap pas hapi. Aktualisht Serbia ndërmjet vendeve sllavo-jugore është më e sukseshmja, dhe do të doja që vërtet në gjithë vendin të hapet si një mundësi sipërmarrje. Për këtë faktori njeri ekziston, dhe një mbështetje ekonomike nga ana e firmës.FLP është një firmë e fuqishme multinacionale. I ka të gjitha talentet: një sistem marketingu të përsosur, dhe shumë bashkpunëtorë drejtues shumë të mirë.

Tibor Radóczki në fjalën e tij tha:“Të jeni krenar për atë që jemi pjestar dhe si sipërmarrës të barabartë të një firme botërore me

3 miliard dollarë, që vepron në 160 vende të botës dhe prej 35 vjetësh ecën vetëm në ngjitje.

Eleonora dhe József theksuan se u janë mirënjohës sponsorve Ildikó dhe Rudolf Molnár që 4 muaj para hapjes u prezantuan atyre mundësinë e ofruar nga Forever Living Products. Po kështu u janë mirënjohës linjës së sipërme Tibor Radoczki dhe Dr Ilona Gurka, për atë që i kanë mbështetur dhe motivuar vazhdimisht

dhe si shqiptonja të vërteta kanë mundur të ngjiten lart falë mundësive Forever. Me këtë rast miqtë e ardhur i qerasën me koktejl të veçantë të përgatitur me Aloe.

Në kuadrin e zyrës të informacionit marrin përgjigje ditët e biznesit, organizohen ditët e shëndetit dhe të interesuarit marrin përgjigje për çështje të sigurisë materiale dhe të shëndetit. Sipas Eleonorës, krahas pavarësisë materiale, ka rëndësi që fëmijve tu sigurojmë një shëndet dhe të ardhme më të lumtur.

Në të ardhmen e afert, në qendrën e qytetit , në Szabadká, planifikohet hapja e një qendre më të madhe biznesi dhe zyresh. Kjo do të quhet Aloe Info II. Me këto plane dhe endërra ecim me hapa të sigurt në rrugën drejt

“Qëndrën Aloe Info Centar e hapëm në interes të asaj që çdo njeri të mund të njihet me mundësitë fantastike të ofruara nga Foreveri. Në Vojvodinë numeri i të papunëve është i lartë, gjithnjë e më tepër shumë familje janë në vështirësi ekonomike, pa folur për një mënyrë jetese të shëndetshme”


titullit të diamantit!

Kristina Molnár



JÓZSEF SZABÓ ZAFIR MENAXHER

Mendoj, që “libra themeltarë” janë ata, të cilët ofrojnë për ne të gjithë një ndihmë të domosdoshme, që zhvillojnë tek ne një pikpamje jete të tillë, e cila është parakushti për sukses në një sistem MLM. Ne, ndërtuesit e rrjetit e shikojmë çdo gjë me sy tjetër. Ndryshe i shikojmë njerëzit, kohën, marrëdhëniet, detyrat. Duhet të zhvillohemi në një personalitet “tjetër”. Për atë, që të sigurosh, dhe të investosh për gjithë jetën ato njohuri që të çojnë drejt suksesit, mund të të ndihmoj duke të rekomanduar dy librat e mëposhtëm. Apo duke të ndihmuar Ty ashtu, siç më ndihmoi mua autori; kjo është përsëritja e biznesit. Të dashur Miqtë e mi Fillestarë, unë do t’ju rekomandoja këto:



MICHAEL STRACHOWITZ

BAZAT E MARKETINGUT NË RRJET

„Sigurisht ky libër nuk do të zëvendësojë punën tënde të nevojshme për marketingun në rrjet, dhe nuk mund të mbrojë nga ato zhgënjime, për të cilat duhet të jesh i përgatitur. Nuk do të ndalojë ato jo-t dhe kundërshtimet e shumta, të cilat të dalin përpara në rrugën drejt suksesit. Por mund të ndihmojë në atë, që të pakësosh numrin e tyre, dhe ndoshta të mbron nga disa zigzake dhe gabime në rrugën e gjatë por rezultative drejt qëllimit tënd final.”

Libri midis të tjerash përshkuan atë, se cili është ndryshimi midis marketingut të drejt për drejtë dhe marketingut në rrjet, cilat parime bazë dhe ligjshmëri të çojnë drejt ndërtimit të suksesshëm të rrjetit, atë

mënyrë gjeniale, me të cilën mund të krijosh listë emërore gjigande, si mund ti ftosh të interesuarit në prezantime biznesi, cilat mënyra drejtuese funksionojnë mirë, si mund të vendosësh objektiva dhe si mund ti arrish ato.

MICHAEL STRACHOWITZ

HELMI I PËRDITSHËM... AI ËSHTË KUNDËRSHTARI I SUKSESTIT

Trajneri i suksesshëm, doktori i plagëve therëse të ndërtuesve fillestarë të rrjetit, në këtë libër na tërheq vëmendjen për kurthet e helmuara të rrugës me gropa, të cilat ngarkojnë rrugën e ndërtimit të rrjetit. Dënon pa përjashtim të gjithë atë sulm, me të cilin ne jo vetëm prishim çdo ditë mundësit tona në ndërtimin e rrjetit, por edhe atë se si veprojnë bashkëshortët dhe bashkëshortet tona. Jep këshilla dhe receta që kuptohen lehtë për sigurimin e masave parandaluese dhe trajtimin e helmeve tona të përditëshme. Bile, tani, që përsëri shfletova këto dy vepra, të dashur bashkpuntorë që së bashku punojmë prej dhjetë-pesëmbëdhjet vjetësh, edhe për veten tonë po këto libra do të rekomandoja. Mendimet që gjenden brenda tyre janë eksperiencat e një zotërie të trajnuar për tridhjet vjet në ndërtimin e rrjetit. Çfarë mund të shtoj unë akoma tek fjalët e tij? Jo shumë, sepse edhe unë prej këtyre mësova bazat. Kështu që No comment, Lexojini, Miqt e mi!





NIVELIN E MENAXHERIT E ARRITËN



Bernadett Csóka Kovácsné dhe Péter Kovács
(Sponsor *Tímea Takács Rózsáné dhe Imre Rózsa*)
„Në qoftë se ke rezistencën tënde të brëndshme, nuk ka pengesa të jashtëme”



Attila Schwarcz
(Sponsor *Anna Tauber Mentésné dhe Gábor Mentés*)
„Kurrë mos thuaj kurrë”



Daniel Stajdohar dhe Martina Stajdohar
(Sponsor *Stjepan Belosa dhe Snjezana Belosa*)
Kur të gjithë janë kundër teje, do të thotë se që je plotësisht gabim ose ke plotësisht të drejtë. Mos shiko çfarë mendojnë të tjerët, duhet të kesh besim tek vetja. Ne kemi besim tek vetvetja”



NIVELIN E ASSISTANT MANAGER-IT E ARRITËN

Davidović Milica & Lučić Aleksandar
Dobos Krisztina
Dr. Király Tünde & Nagy Károly
Láng Andrásné & Láng András
Parac Damir

Begović Jelena & Begović Sladjan
Božinovski Ines & Božinovski Blaže
Brljak Zlatko
Budavári Gergely
Dr. Dobos Attila
Dr. Matúz Dezső
Dr. Sándor Erzsébet & Nagy Gyula
Fülöp Mónika
Gregov Ružica & Gregov Dražen
Hack Imréné & Hack Imre
Jedlicska László
Kemenczki Péter & Kemenczkiné Pallagi Anita
Koltai János
Lak Laslo & Ceri Renata

Lisak Mirko & Ivošević Svetlana
Lukanic Zarko & Lukanic Brankica
Maslesa Predrag & Maslesa Kristina
Mezei Blanka
Murganic Đurđina & Murganic Dragiša
Nytó Tibor & Nyitóné Endrédi Erzsébet
Ríchlík Istvánné
Slavinec Branka
Slovensky Noémi & Simó Károly
Sztyc Slavica & Đurđević Nikola
Tot Ibolja & Stojanović Tomislav
Živković Bojan
Zöldi Gábor & Zöldi-Keil Szilvia



NIVELIN E SUPERVISOR-I E ARRITËN

Battancs Szilveszter

FITUESIT E PROGRAMIT MOTIVUES TË BLERJES SË MAKINËS

NIVELI 1-rë

Jožica Arbeiter & Dr. Miran Arbeiter
Bezc Zoltán & Kenesei Zsuzsanna Viktória
Bruckner András & Dr. Samu Terézia
Budai-Schwarcz Éva
Marija Buruš & Boško Buruš
Csuka György & Dr. Bagoly Ibolya
Davis Erika & Davis Henry
Dr. Dósa Nikolett
Éliás Tibor
Fekete Zsolt & Ruskó Noémi
Ferencz László & Dr. Kézmárki Virág
Olivia Gajdo
Gecse Andrea
Gombás Csilla Anita & Gombás Attila
Gyurik Erzsébet & Sándor József
Hajcsik Tünde & Láng András
Heinbach József & Dr. Nika Erzsébet
Hertelendy Klára
Rinalda Iskra & Lučano Iskra
Vladimír Jakupak & Nevenka Jakupak
Dragana Janović & Miloš Janović
Juhász Csaba & Bezzeg Enikő
Sonja Jurović & Zlatko Jurović
Dr. Keresztényi Albert

Kis-Jakab Árpád & Kis-Jakabné Tóth Ibolya
Dr. Kiss Ferenc & Dr. Nagy Ida
Klaj Ágnes
Jadranka Kraljić-Pavletić & Nenad Pavletić
Kúthi Szilárd
Lapicz Tibor & Lapiczné Lenkó Orsolya
Mázás József
Dr. Molnár László
& Dr. Molnár-Stantić Branka
Múladi Annamária
Nagy Andrea
Vaselije Njegovanović
Dr. Marija Ratković
Dr. Rokonay Adrienne & Dr. Bánhegyi Péter
Sebők Judit
Senk Hajnalka
Dr. Seresné Dr. Pirkhoffer Katalin
& Dr. Seres Endre
Dr. Szénai László
& Dr. Szénainé Kovács Gabriella
Tanács Ferenc & Tanács Ferencné
Varga Géza & Vargáné Dr. Juronics Ilona
Varga Józsefné
Jozefa Zore
Zsidai Renáta

NIVELI 2-rë

Haim Józsefné & Haim József
Kása István & Kása Istvánné
Leveleki Zsolt & Leveleki Anita
Dr. Németh Endre & Lukácsi Ágnes
Orosházi Diána
Siklósné Dr. Révész Edit
& Siklós Zoltán
Tihomir Stilin & Maja Stilin
Utasi István & Utasi Anita

NIVELI 3-rë

Berkics Miklós
Tomislav Brumec & Andreja Brumec
Halmi István
& Halminé Mikola Rita
Herman Terézia
Krizsó Ágnes
Stevan Lomjanski & Veronika Lomjanski
Dr. Milesz Sándor
Szabó József
